



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1216/3 prot.

Tiranë më 09.9.2019

VENDIM

Nr. 28, datë 09.9.2019

PËR KONTROLLUESIN "*Xhilda Kasmi – City Fitness Club*"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Xhilda Kasmi – City Fitness Club*",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.222, datë 02.08.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "*Xhilda Kasmi – City Fitness Club*" me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Kontrolluesi "*Xhilda Kasmi – City Fitness Club*" operon në sektorin e fitnesit dhe tregtimin e produkteve për palestër nga viti 2012 e në vijim. Kategoritë e subjekteve të cilëve iu përpunohen të dhënat personale janë "*punëmarrës*", dhe "*klientë*".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*Xhilda Kasmi – City Fitness Club*" konstatoi se:

1. Kontrolluesi, nuk ka "*Njoftuar*" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të plotësojë kontrolluesi përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë, pra që në momentin e fillimit të aktivitetit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar: "*...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë*".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "d" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregulla specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", pika 2/1: "*Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera*".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "dh" të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

3. Kontrolluesi ka një sistem video-survejimi (CCTV), të përbërë nga 11 kamera. Kontrolluesi njofton klientët dhe punonjësit në lidhje me praninë e sistemin CCTV me tabela informuese, megjithatë këto tabela nuk janë sipas standardit të Udhëzimit nr.3/2010, të Komisionerit. Afati i ruajtjes së imazheve të sistemit CCTV është 7 ditë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 03, datë 05.03.2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*".



Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 300.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "b" të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

4. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar me punonjësit "Deklaratën e Konfidencialitetit" në zbatim të nenit 28 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i deklaruesit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhënat që i mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëhershme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 06/2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurinë e të dhënave personale".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "dh" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit, datë 07.08.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit parashtroi këto pretendime: "Nuk jam dakord për sa i përket mangësive të shkruara në procesverbal, sepse nuk kemi qënë të informuar rreth këtij ligji. Kemi punuar në bazë të rregullave në lidhje me të dhënat personale dhe ambienteve informuese duke ruajtur çdo të dhënë personale të klientëve dhe privatësinë e tyre"

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Xhilda Kasmi – City Fitness Club" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 04.09.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi, nuk është paraqitur në seancë dëgjimore dhe as ka dërguar prova në rrugë zyrtare për të vërtetuar rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ të cilat konsistojnë në mos plotësimin e Formularit të Njoftimit, Rregullores specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale", informimin nëpërmjet tabelave, lidhur me praninë e sistemit të video-survejimit CCTV, nënshkrimin e

*"Deklaratave të Konfidencialitetit"* me punonjësit që përpunojnë të dhëna personale në kuptim të nenit 39, pika 1, gërmat "d" "b" dhe "dh" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- d. *"Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë"*;
- b. *"Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, sipas përcaktimit në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë"*;
- dh. *"Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 150.000 lekë"*.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara në lidhje me njoftimin dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave janë serioze. Rezulton nga të dhënat e regjistrit elektronik të shoqërive tregtare se *"Xhilda Kasmi – City Fitness Club"*, ushtron aktivitetin tregtar nga viti 2012 e në vijim. Megjithatë, është marrë në konsideratë edhe fakti që pranë kontrolluesit nuk është kryer hetim administrativ i mëparshëm, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve, 18, 21, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1 gërmat "d", "b" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit *"Xhilda Kasmi – City Fitness Club"* me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit *"Xhilda Kasmi – City Fitness Club"*, me gjobë në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit *"Xhilda Kasmi – City Fitness Club"* me gjobë në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.
4. Dënimin e kontrolluesit *"Xhilda Kasmi – City Fitness Club"* me gjobë në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 28, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.



5. Kontrolluesi "Xhilda Kasmi – City Fitness Club", të plotësojë "Formularin e Njoftimit", të hartojë rregulloren specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", të nënshkruaj "Deklaratat e Konfidencialitetit" me punonjësit që përpunojnë të dhëna personale, si dhe të informojë subjektet e të dhënave mbi praninë e sistemit të video-survejjimit, nëpërmjet tabelave informuese brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij Vendimi. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
7. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 09/9.2019

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

